



## **KONTROLLI I LARTE I SHTETIT K R Y E T A R I**

Nr. 239/7 Prot.

Tiranë, më 30.06.2016

### **V E N D I M**

**Nr.81, Datë 30.06.2016**

#### **PËR EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË BASHKINË MALIQ "MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE"**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik , Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, dhe mendimin e Drejtorit të Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, dhe 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

#### **V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të ushtruar në Bashkinë Maliq, për periudhën nga data 01.01.2013 deri më datë 31.12.2015.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

## A. MASA ORGANIZATIVE:

**1. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Maliq nuk janë implementuar kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi nuk janë evidentuar risqet dhe masat për menaxhimin e tij, rregulla për administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme, gjurmët e auditimit, zonat me risk dhe rrjedhimisht nuk është përpiluar strategjia për menaxhimin e tij, si dhe nuk është hapur regjistri i riskut.

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq, të marrë masa dhe të vlerësojë shkeljet e konstatuara të kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të hartojë planin për ngritjen e sistemit të kontrollit dhe metodologjinë për zbatimin e tij, të hartohet dhe miratohet Kodi Etik, të identifikohet dhe të krijohet regjistri i riskut, si dhe të plotësohet me organikë Njësia e Auditimit të Brendshëm, si strukturë që jep siguri për funksionimin e kontrollit të brendshëm.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi.** Nuk janë zbatuar kërkesat e VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, mbi procedurat e transferimit të pronave në NJQV<sup>ve</sup>.

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq (Zyra e Kadastrës), të marrë masa për inventarizimin, evidentimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP.

*Brenda muajit Shtator 2016*

**3. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Maliq ka funksionuar pa një rregullore të brendshme, ku të mund të përcaktoheshin detyrat përkatëse për çdo sektor/zyrë dhe punonjës. Nuk ka funksionuar sektori i administrimit të pronave të Bashkisë, si dhe nuk janë ngritur grupe pune për inventarizimin, evidentimin dhe regjistrimin e pronave të Bashkisë, në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar dhe VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”.

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq, të hartojë dhe miratojë Rregulloren e Brendshme të funksionimit të strukturave të bashkisë, duke përcaktuar detyrat për çdo zyrë/sektor.

Të miratojë strukturën e pronave publike dhe menaxhimit të aseteve, si dhe të ngrejë grupet e punës për të plotësuar me dokumentacionin e mjaftueshëm e nevojshëm pronat e transferuara nga institucionet që i kanë pasur në inventar, me qëllim vlerësimin paraprak dhe regjistrimet në kontabilitet, në përputhje me pikën 22, të VKM<sup>së</sup> nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”.

*Në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak*

**4. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Maliq, nuk ka miratuar Instrumentin e Përgjithshëm Ndërvendor dhe Planin e Detajuar Vendor, veprime në mospërputhje me nenin 40, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar.

**4.1. Rekomandimi:** Zyra e Planifikim Territorit Urban, të marrë masa për hartimin dhe miratimin në Këshillin Bashkiak dhe më pas në KKT, Instrumentin e Përgjithshëm Ndërvendor dhe Planin e Detajuar Vendor.

*Brenda muajit Shtator 2016*

**5. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Maliq nuk është miratuar struktura e Inspektoratit Vendor i Mbrojtjes Territorit (IVMT) ose lidhur aktmarrëveshje me IKMT Dega Korçë, në zbatim të neneve 4,6 dhe 18, të ligjit nr. 9780, datë 16/7/2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”.

**5.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë të paraqes në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak, material për krijimin e strukturës së Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes Territorit (IVMT), ose në mungesë personeli të kualifikuar të lidhë aktmarrëveshje me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes Territorit, Dega Korçë.

*Brenda muajit Shtator 2016*

**6. Gjetje nga auditimi:** Në mbyllje të periudhave ushtrimore, nuk kontabilizohen faturat e energjisë elektrike, të ujit, Albtelekomit dhe postare, duke mos pasqyruar kështu detyrimet ndaj të tretëve, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 26, datë 27.12.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësitë që varen prej tyre”, i ndryshuar.

**6.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të marrë masa për kontabilizimin e faturave të energjisë, të ujit, Albtelekomit, postare etj, dhe detyrimet e pasqyruara në bilanc të rakordojnë me shpenzimet e programuara të vitit pasardhës.

*Në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Për aktivet afat gjata dhe afat shkurtra, të vlerësuara për të dalë jashtë përdorimit por ende të pa nxjerra, nuk pasqyrohen në llogarinë përkatëse 24-Aktive të qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara, siç përcaktohet në UMF nr. 26, datë 27.12.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 14, datë, 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësitë që varen prej tyre”, i ndryshuar.





**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e veprimeve në kontabilitet dhe pasqyrimin e aktiveve afat gjata e afat shkurtra në llogarinë përkatëse 24-Aktive të qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara.

*Në vijimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin mbi administrimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullotave të ish-Komunave Moglic, Libonik, Gore dhe Pojan, u konstatua se kryejnë aktivitet shfrytëzim karriere subjekte private, duke shfrytëzuar sipërfaqe pyjore/kollusore në pronësi/përdorim të këtyre Njësive Vendore të miratuar me VKM përkatëse, gjithsej prej **45.612 ha**. Këto subjekte nuk kanë bërë të mundur lidhjen e kontratave për sipërfaqet që ato kanë në përdorim, me qëllim përlllogaritjen dhe pagesën e qirasë, duke sjellë mungesë të ardhurash me efekt negativ në buxhetet e tyre për vlerën **12,714,863 lekë**, veprime këto në

kundërshtim me ligjin nr. 9791, datë 23.07.2007 Për disa ndryshime në ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar me ligjin nr. 9533, datë 15.05.2006, neni 38, germa “q” dhe nenin 40/1-*Vlerësimi i dëmit*, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal”, pika 4,6 dhe 11, VKM nr. 391, datë 21.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja 2, si dhe ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”.

**8.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq në bashkëpunim me Njësitë Administrative Moglic, Libonik, Gore, Pojan dhe Drejtorinë e Shërbimit Pyjorë Korçë, të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve pyjore dhe kollusore të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke lidhur kontrata ligjore, para noterit publik, në përputhje me nenin 39 germa f, nenet 40, 54, 56, të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, dhe pikat 3, 4, 7, të Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005, të ndryshuar, duke përcaktuar dhe arkëtuar detyrimet për qiranë në vlerën **12,714,863 lekë**, respektivisht:

- Shoqëria “” shpk për sipërfaqen 2.6 ha me vlerë **2,669,333 lekë**,
- Shoqëria “” shpk për sipërfaqen 8.05 ha me vlerë **5,902,530 lekë**,
- Shoqëria “” shpk për sipërfaqen 2.5 ha me vlerë **3,300,000 lekë**
- Shoqëria “”shpk, për sipërfaqe 0.5620 ha me vlerë **843,000 lekë**.

*Brenda muajit Korrik 2016*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pikën 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullor”, pikat 3, 7, 7, 9, 10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”.

**9.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq t’i kërkojë Ministrisë Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave, Ministrisë Energjetikës dhe Industrisë, që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjorë dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kollusore të mbetura.

Gjithashtu për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimin e veprimtarisë të Kompanive minerare private, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private.

*Brenda muajit Korrik 2016*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nuk është ndjekur me përparësi zbatimi i dispozitave të Kreut VI-*Monitorimi i Kontratave*, mbi ecurinë e tyre, mirëmbajtjen e objektit, numrin e të punësuarave, sipërfaqen e shfrytëzueshme, etj, si dhe nuk është zbatuar kapitulli VI, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës

së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, për paraqitjen e informacionit mbi zbatimin e plan biznesit që bashkëlidhet kontratave.

**10.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të analizojë dhe monitorojë 3 (tre) kontratat e lidhura deri në fund të vitit 2015, duke parë zbatimin e plan bizneseve të paraqitura në momentin e lidhjes së tyre dhe për rastet kur këto plane nuk kanë gjetur zbatim, të kërkohet zbatimi i plan biznesit ose prishja e tyre. Në të gjitha rastet kontratat lidhura duhet të jenë të noterizuara.

*Në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Maliq dhe 6 Njësitë Administrative në juridiksion të sajë, u konstatua se në fund të vitit 2015 janë 238 subjekte debitorë të biznesit të madh e të vogël, të cilët nuk kanë shlyer taksat dhe tarifat vendore për shumën **5,169,000 lekë**. Për vjeljen e këtyre debitorëve Zyra e Taksave Vendore nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e debitorëve, në kundërshtim me nenin 34, të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenit 12, Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-*Mbledhja me forcë e detyrimeve*, dhe nenit 91, të ligjit nr 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**11.1. Rekomandimi:** Për arkëtimin e detyrimeve tatimore nga 238 subjekte debitorë në shumën **5,196,000 lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, **të nxiren njoftim vlerësimet tatimore, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:**

**a-**Tu dërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

**b-**Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të regjistrimit të pasurive të Paluajtshme Kavajë (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

**c-**Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, të ndryshuar, me ligjin nr.164/2014 datë 15.12.2014, ndaj tyre të llogariten kamat vonesa (gjohë në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë).

**d-**Në rast se Bizneset private edhe pas dërgimit të urdhrë bllokimeve në Bankë dhe njoftimeve zyrtare, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008” ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014, pasi të vendosen masa administrative të bëhet kallëzim penal.

*Brenda muajit Korrik 2016*

**12. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Maliq dhe 6 Njësitë Administrative të kësaj Bashkie deri me datë 31.12.2015, nuk janë mbledhur debitorët familjarë për taksat e tarifat vendore në vlerën **88,258 mijë lekë**, nga e cila; 10078 familje për 10 vjet nga viti 2006-2015 taksë toke në vlerën 64,752 mijë lekë dhe taksë ndërtese e tarifa të tjera vendore 8139 familje për vlerën 23,506 mijë lekë.

**12.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Maliq, të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të marrë masa për arkëtimin e taksave e tarifave me vlerë **88,258 mijë lekë**, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, në zbatim të pikës 71, të UMF nr. 1, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e Buxhetit të Vitit 2016”, duke dërguar

njoftim vlerësimet abonentëve familjarë me anë të Zyrës Postare, në Bashkinë Maliq dhe 6 Njësitë Administrative si më poshtë:

-*Bashkia Maliq*, për taksë toke në 536 familje me vlerë 161 mijë lekë dhe taksë ndërtese e tarifa vendore në 547 familje me vlerë 559 mijë lekë.

-*Njësia Administrative Moglic*, për taksë toke në 647 familje me vlerë 2,875 mijë lekë dhe taksë ndërtese e tarifa vendore në 766 familje me vlerë 66 mijë lekë.

-*Njësia Administrative Pojan*, për taksë toke në 2612 familje me vlerë 4,512 mijë lekë dhe taksë ndërtese e tarifa vendore në 2252 familje me vlerë 2,615 mijë lekë.

-*Njësia Administrative Libonik*, për taksë toke në 2304 familje me vlerë 36,016 mijë lekë dhe taksë ndërtese e tarifa vendore në 2265 familje me vlerë 11,802 mijë lekë.

-*Njësinë Administrative Gore*, për taksë toke në 912 familje me vlerë 229 mijë lekë dhe taksë ndërtese e tarifa vendore në 349 familje me vlerë 1,373 mijë lekë.

-*Njësinë Administrative Pirg*, për taksë toke në 1384 familje me vlerë 8,435 mijë lekë dhe taksë ndërtese e tarifa vendore në 1082 familje me vlerë 2,093 mijë lekë.

-*Njësinë Administrative Vreshtaz*, për taksë toke në 1660 familje me vlerë 12,524 mijë lekë dhe taksë ndërtese e tarifa vendore në 877 familje me vlerë 4,998 mijë lekë.

***Brenda muajit Shtator 2016***

**13. Gjetjet nga auditimi:** Për vitet 2013, 2014 dhe 2015 kanë ushtruar aktivitet pa qenë të regjistruar 25 subjekte. Mos regjistrimi i këtyre subjekteve në QKR, ka sjellë mos llogaritjen dhe arkëtimin e detyrimeve për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në vlerën 2,438,832 lekë, veprime në kundërshtim me nenet 40 dhe 41, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**13.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçë dhe ti kërkojë për regjistrimin e **25 subjekteve** në QKR me qëllim arkëtimin e detyrimeve të Kontributeve për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore me vlerë **2,438,832 lekë**, të cilët kanë ushtruar aktivitet të pa licencuar.

***Brenda muajit Korrik 2016***

**14. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Rajonale Shëndetësore Korçë sipas fletë daljes nr. 1, datë 08.03.2013 nënshkruar nga ish-Kryetari i Komunës Moglicë **A.B.** (marrësi në dorëzim), i është bërë dalje Komunës Moglicë 1 Mjet tip “*Mitsubishi Pajero*” me nr. shasie JMBL44GVKJ416046, ngjyrë gri me targë KO 6790 A me vlerë **800,700 lekë**. Fletë dalja është shoqëruar me urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 114, datë 04.03.2013 në të cilën është cilësuar se: Të bëhet kalim kapital nga Drejtoria e Shëndetit Publik të Qarkut Korçë në Komunën Moglicë, me qëllimin e vetëm për tu përdorur nga Qendra Shëndetësore Moglicë, për mbulimin e nevojave të shërbimit të kujdesit shëndetësor të popullatës. Nga ana ish-Komunës, nuk janë kryer veprimet në kontabilitet dhe për pasojë nuk është përfshirë në inventarë fizik të viteve 2013, 2014 dhe 2015.

Në kundërshtim me, pikat 10,13,14 dhe 15, të UMF nr. 30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, dhe pika 2 e kreut VI, të VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve

të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe të çdo dokumentacioni tjetër zyrtarë në një sitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

**14.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq të marrë masa dhe të ngrëjë një komision të posaçëm , për vlerësimin e gjendjes së makinës dhe të kryhen veprimet si, duke bërë hyrje me gjendjen fillestare vlerën **800,700 lekë** dhe përfshirja në inventarin fizik. Nëse makina nuk dorëzohet nga ish-Kryetari i Komunës **A.B.** i cili ka marrë përsipër dorëzimin e makinës në ballafaqimin e kryer në KLSH me datë 13.06.2016. Të hartohet procesverbal dhe ndaj tij të pritët urdhër zhdëmtimi.

*Brenda muajit Korrik 2016*

**15. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e dokumentacionit të veprimeve me bankë të ish - Komunës Libonik, u konstatua se për periudhën 2013-2015 janë marrë me qira 8 objekte për të cilën është likuiduar **vlera 1,126,500 lekë**, respektivisht:

Kontrata me subjektin “ [REDAKTUAR] ” me objekt “*dhomë pensionistësh*” për sipërfaqen 50 m<sup>2</sup>, kontrata me subjektin “ [REDAKTUAR] ” me objekt “*kopsht*” me sipërfaqe 50 m<sup>2</sup>, kontrata me subjektin “ [REDAKTUAR] ” me objekt “*dhomë pensionistësh*” me sipërfaqe 85 m<sup>2</sup>, kontrata me subjektin “ [REDAKTUAR] ” me objekt “*kopsht*” me sipërfaqe 56 m<sup>2</sup>, kontrata me subjektin “ [REDAKTUAR] ” me objekt “*shkollë*” me sipërfaqe 16 m<sup>2</sup>, kontrata me subjektin “ [REDAKTUAR] ” me objekt “*kopsht*” me sipërfaqe 30 m<sup>2</sup>, kontrata me subjektin “ [REDAKTUAR] ” me objekt “*shkollë*” me sipërfaqe 35 m<sup>2</sup> dhe kontrata me subjektin “ [REDAKTUAR] ” me objekt “*kopsht*” me sipërfaqe 16 m<sup>2</sup>.

Kontratat e mësipërme të lidhura me subjektet private janë në kundërshtim me nenit 4, pikat 14, 23 e 24, nenet 8, 9 e 29, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe pikat 35 e 36, të Udhëzimit Ministrisë nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik datë 27.12.2011.

**15.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Njësinë Administrative Libonik, të marrë masa për ndërprerjen e kontratave të objekteve të marra me qira, duke ndjekur procedurat ligjore, për riformulimin e kontratave të reja sipas dispozitave ligjore.

*Brenda muajit Korrik 2016*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:**

Mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa V, kreu I-*Akti administrativ*, nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 21-33 Funksionimi dhe kompetencat e njërive të vetëqeverisjes vendore; ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 608-628 në vijim, dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV-*Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve*, pika 93, **nga ana e titullarit të njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e

nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim për **shpërblimin e dëmit në vlerën 25,741,355 lekë, si më poshtë:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Këshilltaret e Bashkisë Maliq edhe pse nuk kanë marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë paguar për vlerën **1,109,856 lekë**, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 29, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimi dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe pikën 69, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Maliq të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **1,109,856 lekë**, ndajë **35** këshilltarë dhe ish-këshilltarë të Bashkisë Maliq, për sa kanë përfituar shpërblime mujore pa marrë pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak.

*Brenda muajit Korrik 2016*

**2. Gjetje nga auditimi:** Në ish-Komunën Moglicë, në tenderin e zhvilluar me objekt: *“Hapje kanali për ujësjellësin Moglicë faza e parë”*, me fond limit 833,333 lekë dhe vlerë të lidhjes kontratës 830,000 lekë, u konstatuan këto mangësi:

Mungon përlllogaritja e fondit limit (preventivi i Komunës) dhe nuk është ngritur grup pune për këtë qëllim. Nuk ka projekt dhe preventiv nga autoriteti kontraktor, veprime në kundërshtim me pikën 2 e Kreut II, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Njësia e prokurimit në hartimin e DST nuk ka përcaktuar kërkesat minimale që duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë: *Licenca profesionale për ndërtimin e objektit, xhiron mesatare të tre viteve të fundit nga administrata tatimore, bilancin e konfirmuar nga autoritetet përkatëse, punime të ngjashme të kryera.*

Nuk është firmosur nga njësia e prokurimit proces verbali mbi hartimin e dokumenteve të tenderit, në kundërshtim me germa (a) e pikës 1 e kreut III, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në kualifikimin e KVO, është shpallur fitues “” Shpk i cili nuk disponon licencë për ndërtim, vërtetuar nga ekstrakti i Regjistrit Tregtar dhe vërtetimi nr. 799, datë 21.02.2014.

Është s’kualifikuar “” Shpk me çmimin më të ulët edhe pse, disponon licencën profesionale, veprim në kundërshtim me nenin 2, të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duke shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 150,000 lekë.**

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **150,000 lekë** ( 830,000 - 680,000), në ngarkim të; *anëtarëve të Njesisë së Prokurimit i përbërë nga; B.M. me detyrë jurist i jashtëm (pa kontratë) në vlerën 25,000 lekë, E.C. me detyrë ish- sekretare e Këshillit në Komunën Moglicë në vlerën 25,000 lekë dhe R.Zh. me detyrë ish-përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve Komuna Moglicë në vlerën 25,000 lekë, si dhe anëtarëve të KVO i përbërë nga; M.K. me detyrë inspektor finance në Moglicë në vlerën 25,000 lekë, K.M. me detyrë ish polic Komuna Moglicë në vlerën 25,000 lekë dhe P.M. me detyrë ish-përgjegjës personeli në vlerën 25,000 lekë.*

*Brenda muajit Korrik 2016*



**3. Gjetje nga auditimi:** Për objektin “*depo sheqeri, depo bërsive, repart ambalazhimi, depo+sipërfaqe funksionale*” me adresë ish-Kombinatit të Sheqerit Maliq, është lidhur kontrata nr. 455regj/151prot, datë 05.05.2014, midis Bashkisë Maliq dhe subjektit “██████████”, për sipërfaqen e ndërtimit 3133 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqen funksionale 2640 m<sup>2</sup>, me afat 20 vjet dhe tarifë mujore 274,575 lekë.

Sipas pretendimeve të Bashkisë Maliq, subjekti ka derdhur detyrim deri në muajin Janar 2015, pasi në muajin Shkurt 2015 kjo pronë është kaluar në administrim të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Sipërmarrjes.

Referuar pikës 2, të VKM nr. 590, datë 01.07.2015 “Për një ndryshim në vendimin nr. 41, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për një ndryshim në vendimin nr. 378, datë 12.8.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e së drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte, pronë publike, organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe një ndryshim në vendimin nr. 127, datë 2.2.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Maliq, të Qarkut të Korçës”, i kalon e drejta e përfaqësimit në Ministrinë së Zhvillimit Ekonomik dhe Sipërmarrjes në muajin Korrik 2015 dhe për këtë periudhë (Shkurt-Korrik 2015), nga subjekti nuk është likuiduar detyrim për qiranë e objektit dhe sipërfaqes funksionale me **një dëm ekonomik në vlerën 881,587 lekë.**

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq në bashkëpunim me shoqërinë “Kombinati i Sheqerit” sha Maliq, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **881,587 lekë**, në ngarkim të subjektit “██████████” shpk.

*Brenda muajit Korrik 2016*

**4. Gjetje nga auditimi:** Për objektin “*Magazina e thasëve dhe magazina e materialeve+sipërfaqe funksionale*”, është lidhur kontrata nr. 904regj/351prot, datë 24.09.2014, midis Bashkisë Maliq dhe subjektit “██████████” shpk, për sipërfaqen ndërtimit 1100 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqen funksionale 4679 m<sup>2</sup>, me afat 20 vjet dhe tarifë mujore 153,185 lekë.

Sipas pretendimeve të Bashkisë Maliq, subjekti ka derdhur detyrim deri në muajin Shkurt 2015, pasi prona i është kaluar në administrim Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Sipërmarrjes, por referuar pikës 2, të VKM nr. 590, datë 01.07.2015, i kalon e drejta e përfaqësimit në Ministrinë së Zhvillimit Ekonomik dhe Sipërmarrjes në Korrik 2015 dhe për këtë periudhë (Shkurt – Korrik 2015), nga subjekti nuk është likuiduar detyrim për qiranë e objektit dhe sipërfaqes funksionale me **një dëm ekonomik në vlerën 305,370 lekë.**

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq në bashkëpunim me shoqërinë “Kombinati i Sheqerit” sha Maliq, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **305,370 lekë**, në ngarkim të subjektit “██████████”.

*Brenda muajit Korrik 2016*

**5. Gjetje nga auditimi:** Për objekti “*Qendra Tregtare Pojan*”, është lidhur kontratë qiraje nr. 613/1, datë 05.10.2011 me shoqërinë “██████████” shpk me Nipt K83822002N.

Objekti i kontratës është ndërtesa “*Qendra Tregtare Pojan*”, me sipërfaqe prej 560 m<sup>2</sup>, ndërsa sipërfaqja prej 3800 m<sup>2</sup> pjesë e truallit funksional të “*Qendra Tregtare Pojan*”, nuk është pjesë e kësaj kontrate.

Nga verifikimi në vend i objektit, rezulton se kjo sipërfaqe e cila në kontratë është deklaruar si truall i lirë, është sipërfaqe funksionale në funksion të dy godinave të tregut.

Për sipërfaqen funksionale (3800 m<sup>2</sup>) e cila është në shërbim të dy godinave, nuk është lidhur kontratë dhe paguar qira, sipas kapitulli III, të Vendim të KM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, me **një dëm ekonomik në vlerën 2,964,000 lekë**.

**5.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq në bashkëpunim me Njësinë Administrative Pojan, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **2,964,000 lekë, nga subjekti “██████████”**.

*Brenda muajit Korrik 2016*

**6. Gjetje nga auditimi:** Ish-Komuna Pojan ka lidhur kontratë qiraje datë 09.10.2011 me kompaninë “██████████” sha, me objekt: *dhënien e sipërfaqe 250 m<sup>2</sup> për vendosjen e antenave dhe gjeneratorëve, me afat 9 vjeçar (09.10.2011 – 08.10.2020)*.

Nga të dhënat e marrë në sektorin e financës, rezulton se shoqëria nuk ka likuiduar detyrimet e muajve nga Korriku 2015 -Prill 2016, gjithsej në vlerën **250,000 lekë**.

**6.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq në bashkëpunim me Njësinë Administrative Pojan, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **250,000 lekë, nga kompania “██████████”**.

*Brenda muajit Korrik 2016*

**7. Gjetje nga auditimi:** Ish-Komuna Libonik ka lidhur **3 kontrata** me kompanitë celulare “██████████” datë 02.10.2011 për sipërfaqen 250 m<sup>2</sup> me vlerë tarifë vjetore 300,000 lekë, kompaninë “██████████” datë 25.08.2010 për sipërfaqen 300 m<sup>2</sup> me vlerë 225,000 lekë dhe kompania “██████████” sh.a” datë 28.02.2013 për sipërfaqen 200 m<sup>2</sup> me vlerë 200,000 lekë, për vendosjen e antenave dhe gjeneratorëve, me afat 9 vjeçar (09.10.2011 – 08.10.2020).

Nga të dhënat e marrë në sektorin e financës, rezulton se të tre këto kompani nuk kanë likuiduar detyrimet e periudhës Korriku 2015 – Prill 2016, gjithsej në vlerën **625,000 lekë, e ardhur me dëm në buxhet**.

**7.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq në bashkëpunim me Njësinë Administrative Libonik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **625,000 lekë, ndaj kompanive; “██████████” për vlerën 300,000 lekë, “██████████”, për vlerën 225,000 lekë dhe “██████████”, për vlerën 100,000 lekë**.

*Brenda muajit Korrik 2016*

**8. Gjetje nga auditimi:** Ish-Komuna Vreshtas ka lidhur **7 kontrata** për sipërfaqe pyjore/kollusore, të cilat shfrytëzohen nga subjektet private.

Tarifa e qirasë së këtyre kontratave nuk është sipas VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave” lidhja 2, pikat 6/1, 10/4 dhe 10/6, duke mos llogaritur diferencën në vlerën **1,379,300 lekë** dhe detyrime të pa arkëtuara në vlerën **855,589 lekë, e ardhur me dëm ekonomik në buxhet, konkretisht:**

-Kontrata datë 01.04.2009, lidhur me subjektin “██████████” shpk me përfaqësues Z.V, me objekt “*dhënia me qira pjesë e fondit pyjorë dhe kullorë me sipërfaqe 70000 m<sup>2</sup>, për vendosjen aerogeneratorëve dhe sipërfaqen 74000 m<sup>2</sup> për rrugë kalime”, me afat*

*përdorimi 30 vjet dhe të drejtë rinovimi çdo vit*”, për vlerën e qirasë së pallogaritur prej **1,089,000 lekë**.

-Kontrata datë 19.05.2012, lidhur me subjektin [REDAKTUAR], me objekt “*dhënia me qira e tokës kullimore e shkurre me sipërfaqe 10350 m<sup>2</sup> ose 1.035 ha, kohëzgjatja e kontratës 15 vjet, për vend makineri depozitim inertesh dhe shfrytëzim kariere*, me vlerë qiraje të pallogaritur prej **232,900 lekë**.

Gjithashtu sipas të dhënave të zyrës së financës, subjekti rezulton debitor në **vlerën 805,589 lekë**.

-Kontrata datë 06.02.2012, lidhur me subjektin [REDAKTUAR], me objekt “*dhënia me qira e tokës kullimore e shkurre me sipërfaqe 100 m<sup>2</sup> ose 0.01 ha, kohëzgjatja e kontratës 10 vjet, pikë karburanti*”, me vlerë qiraje të pallogaritur prej **10,000 lekë**.

Gjithashtu sipas të dhënave të zyrës së financës, subjekti rezulton debitor në **vlerën 50,000 lekë**.

-Kontrata datë 19.05.2012 e lidhur me subjektin fizik [REDAKTUAR], me objekt; “*dhënia me qira e tokës kullimore e shkurre me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, kohëzgjatja e kontratës 10 vjet, me destinacion lavazh*”, me vlerë qiraje të pallogaritur prej **7,000 lekë**.

-Kontrata datë 02.08.2012, lidhur me subjektin [REDAKTUAR], me objekt “*dhënia me qira e tokës kullimore e shkurre me sipërfaqe 112 m<sup>2</sup> ose 0.0112 ha, kohëzgjatja e kontratës 10 vjet, për aktivitet tregtar*”, për vlerën e qirasë së pallogaritur prej **11,200 lekë**.

-Kontrata datë 22.02.2012, lidhur me subjektin [REDAKTUAR], me objekt “*dhënia me qira e tokës kullimore e shkurre me sipërfaqe 40 m<sup>2</sup> ose 0.004 ha, kohëzgjatja e kontratës 10 vjet, për ndërtim karburanti*”, për vlerën e pallogaritur prej **16,000 lekë**.

-Kontrata datë 22.12.2012, lidhur me subjektin [REDAKTUAR], me objekt “*dhënia me qira e tokës kullimore e shkurre me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup> ose 0.03 ha, kohëzgjatja e kontratës 20 vjet, për gurorë*”, për vlerën e qirasë së pallogaritur prej **13,200 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 78-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq në bashkëpunim me Njësinë Administrative Vreshtas, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **2,234,889**, duke ndryshuar vlerën e kontratës sipas dispozitave të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, konkretisht subjektet: “[REDAKTUAR]” shpk me vlerë **1,089,000 lekë**, “[REDAKTUAR]” me vlerë **13,200 lekë**, “[REDAKTUAR]” me vlerë **60,000 lekë**, “[REDAKTUAR]” me vlerë **1,038,489 lekë**, “[REDAKTUAR]” me vlerë **11,200 lekë**, “[REDAKTUAR]” me vlerë **16,000 lekë**, dhe “[REDAKTUAR]” me vlerë **7,000 lekë**.

*Brenda muajit Korrik 2016*

**9. Gjetje nga auditimi:** Ish-Komuna Gore ka lidhur **8 kontrata** për sipërfaqe pyjore/kullimore, të cilat shfrytëzohen nga subjektet private.

Tarifa e qirasë së këtyre kontratave nuk është sipas VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave” lidhja 2, pikat 2/8 dhe 2/11, duke mos llogaritur shumën gjithsej 11,195,714 lekë, e cila përfaqëson diferencën në vlerën **11,113,934 lekë** dhe kamatëvonesë nga mos likuidimi në afat në vlerën **81,780 lekë**, e ardhur me dëm ekonomik në buxhet, respektivisht:

-Kontrata datë 24.12.2009 me subjektin “██████████” shpk me administrator **S.Xh**, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kollusor publik prej 6520 m<sup>2</sup>, me vlerë qiraje të pallogaritur prej **2,727,775 lekë**.

-Subjekti “██████████” shpk me NIPT K8183009N, administrator z. **S.B**, për kontratat; nr. 1007rep/911klo, datë 12.04.2013 për sipërfaqen 10295 m<sup>2</sup>, me vlerë qiraje të pallogaritur prej **4,306,500 lekë**; nr. s’ka datë 24.02.2012 (pa noter), për shfrytëzimin e sipërfaqes prej 4890 m<sup>2</sup>, me vlerë qiraje të pallogaritur prej **112,470 lekë**; nr. s’ka 24.02.2012 (pa noter) për shfrytëzimin e sipërfaqes 6520 m<sup>2</sup>, me vlerë qiraje të pallogaritur prej **149,960 lekë**.

-Kontrata datë 17.09.2013 (pa noter) me subjektin “██████████” shpk me përfaqësues ligjore **V.LI**, për shfrytëzimin e sipërfaqes 4876 m<sup>2</sup>, me vlerë qiraje të pallogaritur prej **45,347 lekë**.

-Kontrata datë 03.10.2013 (pa noter) me subjektin “██████████” shpk me përfaqësues ligjore **V.F**, për shfrytëzimin e sipërfaqes prej 9400 m<sup>2</sup>, me vlerë qiraje të pallogaritur prej **2,316,810 lekë**, si dhe kamat vonesat nga mos likuidimi në afat i detyrimeve prej **40,890 lekë**.

-Subjekti “██████████” shpk me përfaqësues ligjore **P.K**, për kontratat; nr. s’ka, datë 27.08.2010 (pa noter), për shfrytëzimin e sipërfaqes 2810 m<sup>2</sup>, me vlerë qiraje të pallogaritur prej **1,433,820 lekë**, si dhe kamatëvonesat nga mos likuidimi në afat i detyrimeve prej **40,890 lekë**; nr. s’ka datë 27.08.2011 (pa noter), për shfrytëzimin e sipërfaqes prej 770 m<sup>2</sup>, me vlerë qiraje të pallogaritur prej **21,252 lekë**.

**9.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq në bashkëpunim me Njësinë Administrative Gore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **11,957,714 lekë**, duke ndryshuar në kontratë vlerën e qirasë sipas dispozitave të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, konkretisht për subjektet: “██████████” me vlerë **2,727,775 lekë**, “██████████” me vlerë **4,569,930 lekë**, “██████████” me vlerë **45,347 lekë**, “██████████” me vlerë **2,357,700 lekë** dhe “██████████” me vlerë qiraje të pallogaritur prej **1,495,962 lekë**.

*Brenda muajit Korrik 2016*

**10. Gjetje nga auditimi:** Ish-Komuna Moglic ka lidhur kontratë nr.s’ka, datë 10.09.2013 (pa noter), me shoqërisë “██████████” shpk me Nipt K21401004R, me objekt; “godinë 1 (një) kat me sipërfaqe 570 m<sup>2</sup>”.

Vlera e qirasë së llogaritur nuk është në zbatim të VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, aneksi A, duke mos llogaritur një diferencë në vlerën prej **1,573,142 lekë**, nga e cila; vlera **96,000 lekë** diferencë llogaritur qiraje, mos likuidim të detyrimeve për vlerën **1,368,500 lekë** dhe kamat vonesën në vlerën **108,642 lekë**.

**Gjithashtu**, konstatohet se me datë 22.07.2015, nga ana e ish-Kryetarit të Komunës z. **A B** është lidhur kontratë shtesë (pa noter), në të cilën nuk është përcaktuar tarifa e qirasë mujore për tarifën 75 lek/m<sup>2</sup>/muaj, duke mos llogaritur detyrim e qirasë për periudhën 2014-2015, në vlerën **327,750 lekë**.

**10.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq në bashkëpunim me Njësinë Administrative Moglic, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **1,900,892 lekë**, ndajë shoqërisë “██████████”.

*Brenda muajit Korrik 2016*

**11. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi, konstatohet se është paguar **S.H.** si Drejtore e Financës në kategorinë II-b, me shtesë për pozicionin, për 34,000 lekë/muaj gjatë vitit 2014 dhe 35,000 lekë/muaj për 8 mujorin e vitit 2015, kur në fakt duhet të paguhej në kategorinë III-b, me shtesë për pozicionin duke marrë nivelin maksimal 29,440 lekë/muaj, pra paguar më tepër për shumën **75,184 lekë**, nga e cila; në vitin 2014 në shumën 41,462 lekë dhe në vitin 2015 në shumën 33,712 lekë, pagesa në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në lidhjen 4, të VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve e grupimin e njësive të qeverisjes vendore dhe caktimin e kufijve të pagave të organeve të qeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 598 datë 27.04.2009, VKM nr. 553, datë 11.8.2011, VKM nr. 518 datë 16.08.2012 dhe VKM nr. 586, datë 17.7.2013.

**11.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Maliq, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **75,184 lekë**, nga punonjësja **S.H.**

*Brenda muajit Korrik 2016*

**12. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e dokumentacionit të paraqitur, u konstatua se janë pajisur me autorizim transporti për nevojat e veta **21 subjekte**, të peregjistruar në QKR. Këto subjekte nuk kanë paguar taksën e biznesit të vogël për veprimtari transporti, për vitet 2013,2014 dhe 2015 për vlerën **988,000 lekë**, e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për Transportin Rrugorë” me ndryshime, Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugorë” me ndryshime, neni 30, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 40 dhe ligjin nr. 9723, datë 03.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, pika 5.

**12.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Policinë Bashkiake, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **988,000 lekë ndajë 21 subjekte** private.

*Brenda muajit Korrik 2016*

**13. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e dokumentacionit të paraqitur, u konstatua se, kanë ushtruar aktivitet të peregjistruar në QKR **2 subjekte**, të cilët kanë shmangur pagesën për detyrimeve për taksën e biznesit të vogël dhe tarifat vendore (vitin 2013), në vlerën **69,000 lekë**, e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik, veprime në kundërshtim me pikën 1 e nenit 40, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe pikat 1,2,3,4 dhe 5 e nenit 41, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

**13.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Policinë Bashkiake, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **69,000 lekë ndajë subjekteve; E.K. në vlerën 30,500 lekë dhe E.H. në vlerën 38,500 lekë.**

*Brenda muajit Korrik 2016*

**14. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e dokumentacionit mbi zbatimin e kontratave të punimeve, u konstatuan punime të pakryera në 3 objekt vlerën 2,479,863 lekë, respektivisht: **-Subjekti (BOE) “ [REDAKTUAR] “ shpk & “ [REDAKTUAR] ” shpk**, ka përfituar tepër punime të pakryera me objekt **“Sistemim trotuare Qyteti Maliq”** në vlerën **794,460 lekë me tvsh**, në mospërputhje me kontratën datë 07.08.2014 dhe ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

**-Subjekti “ [REDAKTUAR] ” shpk**, ka përfituar tepër punime të pakryera me objekt **“Sistemim asfaltimi i rrugës në fshatin Leminot”** në shumën **737,859 lekë me tvsh**, në mospërputhje me kontratën nr. 156, datë 05.06.2013 dhe ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

**-Subjekti “ [REDAKTUAR] ” shpk**, ka përfituar tepër punime të pakryera me objekt **“Rikonstruksion i çatave dhe fasadave të objekteve në rrugën kryesore, Qyteti Maliq”** në vlerën **947,544 lekë me tvsh**, veprim në mospërputhje me kontratën nr. 626, datë 20.07.2015 dhe ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar. Ndërsa shuma **1,116,289 lekë me tvsh** të mospaguhet në situacionin përfundimtar deri në marrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë **(Trajtuar më hollësisht në faqet 59-68, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

**14.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Maliq, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **2,479,863 lekë**, nga 3 subjekteve, respektivisht; **BOE “ [REDAKTUAR] “ & “ [REDAKTUAR] ”** për vlerën **794,460 lekë**, **“ [REDAKTUAR] ”** për vlerën **737,859 lekë** dhe **“ [REDAKTUAR] ” shpk** për vlerën **947,544 lekë**.

**14.2. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Zyrën Juridike, të marrë masa për mos likuidimin situacionit përfundimtarë të punimeve me vlerë **1,116,289 lekë** ndajë subjektit **“ [REDAKTUAR] ” shpk**, deri në marrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë  
**Brenda muajit Korrik 2016**

## **B/1. MASA PËR MOS PËRDORIMIN ME EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurave të prokurimit në tenderin me objekt **“Ndërtim shkolle cikli i ulët, Drithas poshtë”**, me fond limit 9,381,975 lekë, ka mos përmbushje të rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit, mos përdorim me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve publike të vëna në dispozicion, si dhe përdorimin me diferencë negative në fondet buxhetore në vlerën totale **1,603,687 lekë**, veprime në kundërshtim me nenin 2-Parimet e përzgjedhjes, Kreu I-Dispozita të përgjithshme, të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, germa (ç), pika 4-Hapja dhe vlerësimi i ofertave, Kreu V-Zhvillimi i procedurave. **(Trajtuar më hollësisht në faqet 38-68, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Maliq të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë të fondeve publike, për procedurën e prokurimit me efekte

negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën **1,603,687 lekë**, duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

*Brenda muajt Korrik 2016*

## **C. MASA DISIPLINORE:**

### **C-I. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.**

Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore” shkronja “c”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjat “g” dhe “k” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandoj** Kryetarit të Bashkisë që ti kërkojë Komisionit disiplinor, pranë Bashkisë Maliq, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore,

### **“Largim nga shërbimi civil”, neni 58, germa “c”.**

#### **1. G.F, me detyrë Jurist në Bashkinë Maliq, për shkeljet si më poshtë:**

Mos ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve për qiranë e dy objekteve në godinën e ish-Kombinatit të Sheqerit Maliq, sipas kontratave të lidhura për vlerën e dëmit të pa arkëtuar në vlerën **1,186,957 lekë** (dëm ekonomik), veprime në kundërshtim me pikën 2, të VKM nr. 590, datë 01.07.2015 “Për një ndryshim në vendimin nr. 41, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për një ndryshim në vendimin nr. 378, datë 12.8.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e së drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte, pronë publike, organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe një ndryshim në vendimin nr. 127, datë 2.2.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Maliq, të qarkut të Korçës”.

#### **2. R.R, me detyrë Specialist i Pyjeve në Komunën Pojan, për shkeljet si më poshtë:**

-Mos zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9385, datë 04.5.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjorë”, të ndryshuar me ligjin nr. 9791, datë 23.7.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9385, datë 04.5.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjorë” të VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal”, pikave 4 dhe 6, për administrimin e pronave të ish-Komunës Pojan.

-Mos llogaritjen e tarifës së qirasë për sipërfaqen funksionale në shërbim të objekteve të marra me qira, duke mos evidentuar vlerën prej **2,964,000 lekë** (dëm ekonomik), veprime në kundërshtim me kapitulli III, të Vendim të KM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

-Mos zbatimin e procedurave ligjore në zbritjen nga fondi pyjor kollusor të sipërfaqeve të marra në shfrytëzim nga subjektet private, për llogaritjen e detyrimeve që rrjedhin nga dëmtimi i kësaj sipërfaqe në fazën fillestare dhe lidhjen e kontratave të qirasë për sipërfaqet që subjektet marrin në shfrytëzim, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9791, datë 23.7.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9385, datë 04.5.2005 “Për pyjet dhe

shërbimin Pyjor”, të ndryshuar me ligjin nr. 9533, datë 15.5.2006, neni 38, germa “q” dhe neni 40/1-*Vlerësimi i dëmit*, pika 1 e 2, VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve të administrimit të pyllit komunal”, pika 4,6 dhe 11, VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “ Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotave” lidhja 2, VKM nr. 1353, datë 10.10. 2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor, për pikat 3, 7, 8, 9, 10, 11, 12, si dhe VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Per rregullat dhe procedurat qe ndiqen per heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullisor, për pikat 3, 6, 7, 9.

### **“Vërejtje”, neni 58, germa “a”.**

#### **1. A.Z, me detyrë Specialist i Pyjeve në Komunën Libonik, për shkeljet si më poshtë:**

-Mos zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9385, datë 04.5.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin -Mos zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9385, datë 04.5.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjorë”, të ndryshuar me ligjin nr. 9791, datë 23.7.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9385, datë 04.5.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjorë”, VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve të administrimit të pyllit komunal”, pikave 4 dhe 6, për administrimin e pronave të ish-Komunës Libonik.

-Mos zbatimin e procedurave ligjore në zbritjen nga fondi pyjor kollusor të sipërfaqeve të marra në shfrytëzim nga 2 subjektet private, për llogaritjen e detyrimeve që rrjedhin nga dëmtimi i kësaj sipërfaqe në fazën fillestare dhe lidhjen e kontratave të qirasë për sipërfaqet që subjektet kanë marrë në shfrytëzim prej 10.55 ha me vlerë qiranë të pallogaritur prej 9,202.530 lekë (mungesë të ardhurash), veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9791, datë 23.7.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9385, datë 04.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin Pyjor”, i ndryshuar, VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve të administrimit të pyllit komunal”, pika 4,6 dhe 11, VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “ Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotave” lidhja 2, VKM nr. 1353, datë 10.10. 2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor, për pikat 3, 7, 8, 9, 10, 11, 12, si dhe VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Per rregullat dhe procedurat qe ndiqen per heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullisor, për pikat 3, 6, 7, 9.

-Mos zbatimin e procedurave ligjore në vjeljen e detyrimeve të qirasë së antenave celulare për sipërfaqet pyjore të shfrytëzueshme nga kontratat e 3 kompanitë celulare, për vlerën **625,000 lekë** (dëm ekonomik), veprime në kundërshtim me Kreu i XI-*Mbledhja me forcë e detyrimeve*, të ligjit nr 9920 ”Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar.

#### **C-II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.**

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, neni 11, **i rekomandoj**



kryetarit të Bashkisë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, **për 2 punonjësit e mëposhtëm:**

**“Zgjidhjen e Kontratës së Punës”.**

**1. Sh.Zh., me detyrë specialist në Drejtorinë e Taksave Vendore në Bashkinë Maliq, për shkeljet si më poshtë:**

Mos ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve për qiranë e dy objekteve në godinën e ish-Kombinatit të Sheqerit Maliq, sipas kontratave të lidhura për vlerën e dëmit të paarkëtuar në vlerën **1,186,957 lekë**, në kundërshtim me Kreu i XI-*Mbledhja me forcë e detyrimeve*, të ligjit nr 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe pajisje me çertifikatë transporti për 21 subjekte të peregjistruar në QKR, veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për Transportin Rrugorë” me ndryshime, Udhëzimit nr. 15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugorë” me ndryshime, neni 30.

**“Vërejtje me shkrim”.**

**1. N.Gj.me detyrë ish-Përgjegjëse e Zyrës së Planifikim e Zhvillimit Urban, aktualisht Përgjegjëse e Zyrës së Koordinim Zhvillimit në Bashkinë Maliq, për shkeljet si më poshtë:**

-Mos hartimin e dokumentacionit ligjorë, në hartimin dhe miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Ndërvendor dhe të Planit të Detajuar Vendor, veprime në mospërputhje me nenin 40, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar.

-Mos kryerjen e kontroleve në terren për objektet pa leje ndërtimi, veprime në kundërshtim me pikën 2 e nenit 59 -*Rregulloret e kontrollit të zhvillimit të territorit*, ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar.

Mos zbatim të kërkesave të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, mbi procedurat e transferimit të pronave në NJQV<sup>ve</sup>.

**D. MASA ADMINISTRATIVE:**

Bashkia Maliq të marrë masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, për shkelje të neneve 7 dhe 12, të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.3, kontratën e mbikëqyrjes së punimeve me nr. 15, datë 01.03.2013, pikat 2, 5 dhe 6, VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve

teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika 9, si dhe neneve 4 dhe 5, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, të lidhë kontratë me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes Territorit, Dega Korçë dhe **t’i kërkojë të vlerësojë dhe të marrë masë administrative me gjobë për 3 mbikëqyrësit, respektivisht:**

**1. P.P,** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit në objektin “Sistemim trotuare Qyteti Maliq”, me numër liçence MK 1967, pasi është konstatuar dëm ekonomik në vlerën **794,460 lekë** me tvsh shkaktuar si pasojë e diferencave të punimeve të kryera me punimet e situacionuara në mospërputhje me nenin 7, paragrafi i tretë, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

**2. M.T,** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit në objektin “**Sistemim asfaltimi i rrugës në fshatin Leminot**”, me numër liçence MK 1689, pasi është konstatuar dëm ekonomik në vlerën **737,859 lekë me tvsh,** shkaktuar si pasojë e diferencave të punimeve të kryera me punimet e situacionuara në mospërputhje me nenin 7, paragrafi i tretë, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

**3. Z. E.M,** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit në objektin “Sistemim trotuare Qyteti Maliq”, me numër liçence MK 0436/1, pasi është konstatuar dëm ekonomik në vlerën **947,544 lekë** me tvsh shkaktuar si pasojë e diferencave të punimeve të kryera me punimet e situacionuara në mospërputhje me nenin 7, paragrafi i tretë, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

### **Shënim:**

Për 12 ish-punonjësit e mëposhtëm, masa disiplinore për shkeljet të natyrës administrative të konstatuara në auditimin e kryer në Bashkinë Maliq dhe 6 Njësitë Administrative, *respektivisht;* Pojan, Libonik, Vreshtas, Moglic, Gore dhe Pirg, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënie, ndjekje e zbatim.

1. F.A, me detyrë ish-Jurist në Komunën Vreshtas.
2. B.A, me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës së Taksave në Komunën Gore.
3. G.K, me detyrë ish-Spec/Spektori i Urbanistikës në Komunën Moglic.
4. A.M, me detyrë ish-Spec/Pyjeve në Komunën Vreshtas.
5. A.C, me detyrë ish-Spec/Pyjeve në Komunën Gore.
6. K.K, me detyrë ish-Jurist në Komunën Pojan.
7. R.H, në cilësinë e anëtarit të KVO
8. B.M, në cilësinë e anëtarit të KVO
9. E.C, në cilësinë e anëtarit të KVO
10. R.Zh, në cilësinë e anëtarit të KVO
11. K.M, në cilësinë e anëtarit të KVO
12. P.M, në cilësinë e anëtarit të KVO

**E.** Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Maliq, (Njësia e Burimeve Njerëzore), pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe

nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013, "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11-*Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil*, të ligjit nr. 152/2013, "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

*Menjëherë*

## **F. TË TJERA**

Auditimi i kryer në Bashkinë Maliq dhe 6 ish-Komunat (aktualisht Njësitë Administrative) respektivisht: Libonik, Pojan, Vreshtas, Gorë, Pirg dhe Moglicë, vlerësohet dobët nga Kryetari KLSH<sup>së</sup> përse i përket problemeve të trajtuara nga grupi i auditimit dhe për të kontrolluar cilësinë e punës audituese do të riauditohet në një kohë të dytë.

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.*

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**